



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.103 dt.28.09.2001

**PER  
MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TE FONDEVE BUXHETORE NE  
INSTITUCIONET E SISTEMIT TE ARSIMIT NE VARESI TE BASHKISE  
TIRANE**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 neni 32, gërma dh “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit Nr.7776 dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal”, dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.22 dt.13.02.2001 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2001”, kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Njerëzore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Të miratojë transferimin e fondit prej 900 mijë lekë (në Art.602) shpenzime operative në favor të Shkollës Luigj Gurakuqi duke pakësuar Qendrën Ekonomike të Arsimit në shumën përkatëse në Art.602
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit, Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Shkolla Luigj Gurakuqi
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**

